

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë



# STUDIM MBI EFEKTIN E COVID-19 NË KULTIVIMIN E SHALQIRIT TË HERSHËM

Korrik 2020

# **STUDIM MBI EFEKTIN E COVID-19 NË KULTIVIMIN E SHALQIRIT TË HERSHËM**

**Korrik 2020**

**AASF Project Office**  
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7  
Tiranë, Albania  
Tel: +355 69 294 1513  
[www.aasf.com.al](http://www.aasf.com.al)  
[Info@aasf.com.al](mailto:Info@aasf.com.al)

Do të doja të falenderoja të gjithë bashkëpunuesit në përgatitjen e këtij materiali, duke filluar nga kultivuesit e bostanorëve, kompanitë grumbulluese dhe eksportuese, ekspertët e Ministrisë së Bujqësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave etj. Pa bashkëpunimin e tyre ne nuk mund të kishim arritur saktësinë e nevojshme për vlerësimin e situatës të tregtimit të kulturave të familjes bostanore.

Informacioni i paraqitur në këtë studim lejon që të merret një ide e qartë mbi kostot e prodhimit, cmimet, avantazhet konkurruese në rajon, kërkesat e tregut dhe trendi i zhvillimit të këtij sektori.

Shumica e informacionit u siguroi përmes komunikimeve periodike (ditore) dhe vizitave në terren si dhe të dhënave statistikore të UNSTAT dhe FAOSTAT. Informacioni nuk pasqyron vlerat ose praktikatat individuale të një kultivuesi, por janë një mesatare e të dhënave të grumbulluara nga aktorët kryesorë të zhvillimit të këtij sektori.

Ky material do t'i shërbejë aktorëve kryesorë të lidhur me sektorin e kultivimit dhe eksportit të bostanorëve, sistemit bankar dhe ekspertëve të përfshirë në hartimin e politikave bujqësore.

**Ilir PILKU**

Autor i studimit



# PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. TË PËRGJITHSHME.....</b>  | <b>7</b>  |
| <b>2. KULTIVIMI I SHALQIRIT TË HERSHËM NË SHQIPËRI .....</b>                            | <b>11</b> |
| <b>3. NDIKIMI I COVID-19 FERMERËT QË KULTIVOJNË SHALQIRIN DHE AKSESI NË TREGJE.....</b> | <b>19</b> |
| <b>4. KONKLUZIONE.....</b>  | <b>24</b> |



## 1. TË PËRGJITHSHME

“Përhapja e koronavirusit ka një efekt të pashembullt në shoqërinë dhe ekonominë tonë. Farmerët tanë dhe çdo aktor i zinxhirit të furnizimit të ushqimit në BE po punojnë shumë për të mbajtur furnizimin me ushqim të Europës, me gjithë vështirësitë me të cilat përballemi. Komisioni Evropian do të vazhdojë të mbështesë fermerët dhe prodhuesit e ushqimeve, të bashkëpunojë me vendet anëtare të BE-së dhe të marrë çfarëdo masa të nevojshme për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë në Europë” – u shpreh Komisionieri Evropian për bujqësinë, Janusz Wojciechowski.

Ndërsa pandemia Covid-19 përhapet, funksionimi i vazhdueshëm i zinxhirëve të furnizimit me ushqim është thelbësor në parandalimin e një krize ushqimore dhe zvogëlimin e ndikimit negativ në ekonominë globale. Hartimi dhe koordinimi i politikave të duhura janë të nevojshme për të mbështetur agrobiznesin, jetesën dhe kushtet e punës së punëtorëve në bujqësi në përputhje me standardet ndërkombëtare të punës. Pandemia mund të ketë një ndikim serioz në prodhimin dhe përpunimin e kulturave për shkak të fuqisë punëtore, mungesave dhe ndërprerjen e përkohshme të prodhimit. Për shembull, sektori bujqësor në Europë po përballlet me mungesa dramatike të fuqisë punëtore për shkak të mbylljes së kufijve që parandalojnë qindra mijëra punëtorë sezonalë, ferma bujqësore që mbështeten në punën e tyre gjatë periudhës së korrjes. Ndikimi në sektor pritet të jetë afatgjatë. Një numër i madh prodhuesish bujqësor evropian, përfshirë Francën, Gjermaninë, Italinë, Spanjën dhe Poloninë, janë prekur vecanërisht.

Mungesat e fuqisë punëtore (për shkak të sëmundshmërisë, kufizimeve të lëvizjes, rregullave të distancës sociale) kanë filluar të ndikojnë tek prodhuesit, përpunuesit, tregtarët dhe kompanitë e transportit / logjistikës në zinxhirët e furnizimit me ushqim - veçanërisht për produktet ushqimore që kërkojnë që krahu i punës të jetë në afërsi. Sigurimi i fermerëve për të aksesuar inputet dhe punën për sezonin e ardhshëm të mbjelljes është një tjetër çështje shqetësimi në të gjithë vendet. Respektimi i kalendarit të mbjelljeve, shërbimeve agro-teknike, proceseve të vjeljes dhe trajtimeve pas vjeljes kanë ndikuar jo pak në arritjen e rezultateve pozitive të sektorëve bujqësorë.

Në mars 2020, OECD shkurttoi parashikimin e tij për rritjen ekonomike globale në vitin 2020 nga 2.9 përqind në 2.4 përqind, që do të ishte niveli më i ulët që nga kriza financiare e një dekadë më parë, duke paralajmëruar se një epidemi e zgjatur dhe më intensive e koronavirusit madje mund të përgjysmonte këtë shifër në vetëm 1,5 përqind.

Zinxhiri i furnizimit të ushqimit është një rrjet kompleks që përfshin prodhuesit, konsumatorët, inputet bujqësore, përpunimin dhe ruajtjen, transportin dhe marketingun, etj. Deri tani, ndërprerjet janë minimale, pasi furnizimi me ushqim ka qenë adekuat, dhe tregjet kanë qenë të qëndrueshme deri më tani. Rezervat globale të drithërave janë në nivele të mira dhe këndvështrimi i grurit dhe kulturave të tjera kryesore për vitin 2020 është pozitiv.

Ndërkohë që mbyllja e restoranteve dhe turizmit në tërësi largon një treg kryesor për shumë prodhues dhe përpunues që ka shkaktuar një boshllëk të përkohshëm ose mund të ndikojë në ulje të prodhimit. Në disa vende në zhvillim, oferta urbane dhe kërkesa për prodhime të freskëta janë në rënie për shkak të kufizimeve dhe sjelljeve nga tregtarët dhe konsumatorët.



Ky studim është përgatitur nga ekspertët e Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF), i cili është një program i financuar dhe zhvilluar nga BERZH-i (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në bashkëpunim dhe me mbështetje nga qeveria shqiptare, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016. Qëllimi i këtij Programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara - bujqësia dhe agrobiznesi. AASF siguron qasje në financa për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: Linjë kredish dhe/ose shpërndarja e riskut të portofolit për institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjeve që u vu në dispozicion nga Qeveria Shqiptare. AASF përfaqëson një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit. Përfituesit përfundimtarë të AASF janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit, tregtarët me shumicë dhe pakicë. Agrobizneset mund të përfitojnë gjithashtu nga programi i Këshillimit të BERZH-it për Biznesin e Vogël (ASB) një program i mbështetur nga BERZH, i cili ofron konsulencë për zhvillimin e strategjisë, marketingut, ristrukturimin teknik dhe fushat tjera të zhvillimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë.

### **Qëllimi i studimit**

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është që të japë një panoramë të detajuar pas situatës pandemike Covid-19 për kultivuesit e shalqirit të hershëm si një nga aktivitetet më fitim-prurese me një stabilitet ekonomik të qëndrueshëm për një periudhë mëse 10 vjecare. Ky studim do të shërbejë fermerëve dhe eksportuesve të kultures së shalqirit, si dhe sistemit bankar në tërësi.

Për të realizuar qëllimin e këtij studimi janë përdorur burimet parësore dhe dytësore të informacionit/të dhënave, kryesisht referuar statistikave të FAO-s, UNSTAT dhe INSTAT. Gjithashtu duke qënë se statistikave bujqësore për vitin 2019 nuk janë publikuar ende nga INSTAT, janë shfrytëzuar kanalet e komunikimit me Ministrinë e Bujqësisë dhe Dretjtorinë e Përgjithshme të Doganave. Të dhënat operuese për aktivitetet e shqyrtuara i janë referuar Kartave Teknologjike në bujqësi, ndërsa përditësimi i të dhënave mbi cmimet e shitjes në nivel fermer apo atyre të eksportit janë siguruar nga kontaktet e zhvilluara për një periudhë 6 javore me fermerët potencialë dhe 4-5 eksportuesit e mëdhenj në Shqipëri.

### **Origjina e kultivimit të shalqirit**

Shalqiri u kultivua për herë të parë në Afrikë, nga ku u përhap në Evropë, Lindjen e Afërt dhe Indi. Më vonë, filloi kultivimi i tij edhe në Kinë dhe Amerikë.

Ekzistojnë dy hipoteza mbi origjinën e kulturës së shalqirit. E para shpjegon se kjo specie vjen nga popullsia e Afrikës, ndërsa kërkime të ndryshme pohojnë se është origjinale nga një specie Cucurbitaceae që rritet e egër në luginën e Nilit. Ka pak regjistrime të kësaj specie deri në shekullin XVI, por që nga kjo kohë e tutje ajo fillon të jetë shumë e popullarizuar. Në Gadishullin Ballkanik mendohet të ketë ardhur në kohën e invazioneve Turke. Aktualisht, Azia është kontinenti me prodhimin më të lartë të shalqirit, më shumë se 80% të prodhimit në mbarë botën. Afrika, Evropa dhe Amerika e Veriut kanë prodhime të ngjashme, rreth 7-8 milion ton vjetor.

### Trendi i kërkeses botërore për shalqirin

Shalqiri konsumohet i freskët gjatë muajve të verës, por mund të konsumohet edhe si lëng, nisur edhe nga fakti mbi përmbajtjen e lartë të ujit. Shalqiri nuk është i përbërë vetëm nga uji dhe sheqeri, por është gjithashtu një ushqim i bazuar në lëndë ushqyese pasi përmban sasi të lartë të vitaminave, mineraleve dhe antioksidantëve. Ai gjithashtu përmban niacinë, thiamin, vitaminë B-6, zink, magnez dhe shumë më shumë lëndë ushqyese që janë të mira për shëndetin e njeriut. Ka shumë përfitime shëndetësore nga përdorimi i shalqirit pasi është i ulët në kalori, kështu që promovon fito-ushqyes dhe anti-oksidues të domosdoshëm për optimizimin e shëndetit. Ndhmon gjithashtu në parandalimin e astmës pasi posedon sasi të lartë të ushqyesve. Për shkak të fibrave dhe përmbajtjes së tij të shëndetshme të ujit, ndihmon në parandalimin e një sërë sëmundjeve.

| Vlerat ushqyese të shalqit në 100gr |        |
|-------------------------------------|--------|
| Kalori                              | 30     |
| Ujë                                 | 91%    |
| Proteinë                            | 0.6 gr |
| Karbohidrate                        | 7.6 gr |
| Fibra                               | 0.4 gr |
| Sheqer                              | 6.2 gr |

Ka 400 kalori për 1 kg frut të freskët. Shalqini këshillohet si ushqim diuretik për ato që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe të enëve të gjakut, të veshkave, të melçisë së zezë, dhe anemikeve. Në vëndin tonë, shalqini ka kushte shumë të përshtatshme për kultivimin e tij në fushë dhe në ambjente të mbrojtura. Kjo kulturë sa vjen dhe po shtohet në sipërfaqe të hapur dhe të mbrojtura.

Për shkak të përfitimeve të tij shëndetësore, si dhe preferencave të konsumatorit, veçanërisht gjatë kohës së verës, prodhimi i shalqirit po rritet vazhdimisht që nga viti 2005, duke arritur nivelin e rritjes prej rreth 27% (2005-2018). Prodhimi global i shalqirit mbizotëron nga Kina e cila po prodhon më shumë se 67.6% (79.2 milion ton) të prodhimit botëror të shalqirit. Kina pasohet nga vendet e tjera të cilat prodhojnë të gjithë më pak se 4% si vijon: Turqia 3.4% (3.9 milion ton), Irani 3.3% (3.8 milion ton), Brazili 1.8% (2 milion ton) etj. Konsumi mbështetet nga zhvillime të reja në kultivimin e kësaj kulture si dhe në varietetet e reja si ai pa fara dhe në përmasa mini.


Shitjet globale nga eksportet e shalqirit sipas vendeve kanë arritur vlerën e 1.55 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2019. Në përgjithësi, vlera e shalqinjve të eksportuar u rrit me një mesatare prej 2.9% për të gjitha vendet eksportuese që nga 2015 kur dërgesat e shalqirit ishin vlerësuar në 1.51 miliardë dollarë.

Më poshtë janë 15 vendet që eksportuan vlerën më të lartë të dollarit të shalqinjve gjatë vitit 2019:


- Spanja me 473.9 milion dollarë amerikanë (30.5% e shalqinjve të eksportuar);
- Meksika me 143.8 milion dollarë (9.3%);
- Shtetet e Bashkuara: 115.3 milion dollarë (7.4%);
- Italia: 109.3 milion dollarë (7%);
- Marok: 98 milion dollarë (6.3%);
- Hollandë: 95.1 milion dollarë (6.1%);

- Greqia: 63 milion dollarë (4.1%);
- Honduras: 50 milion dollarë (3.2%);
- Brazili: 43.9 milion dollarë (2.8%);
- Vietnami: 41.4 milion dollarë (2.7%);
- Kina: 40.4 milion dollarë (2.6%);
- Kosta Rika: 29 milion dollarë (1.9%);
- Francë: 26 milion dollarë (1.7%);
- Panama: 20.1 milion dollarë (1.3%);
- Malajzia: 18.8 milion dollarë (1.2%)

Eksportet boterore te Shalqirit



Eksportet e BE-se per kulturen e Shalqirit



Ndër kontinentet, furnizuesit Europiane kanë arritur të eksportojnë shalqirin në vlerë më të lartë në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2019, transaksione që arrijnë në vlerën e 840.2 milion dollarë ose mbi gjysmën (54.1%) të eksporteve në të gjithë botën. Në vendin e dytë radhiten eksportuesit e Amerikës së Veriut me 16.7%, ndërsa 10.7% e eksporteve totalë të shalqinjve kishin origjinë nga Amerika Latine (10.7%) duke përfshirë Meksikën, por duke përfshirë Karaibet dhe me rradhë Azia me 9.9 % dhe Afrika me 7.8%.

## 2. KULTIVIMI I SHALQIRIT TË HERSHËM NË SHQIPËRI

Shqipëria prodhon rreth 260,000 ton/vit shalqinj, ku rreth 55% e këtij prodhimi i takon prodhimit të hershëm që fillon vjeljen rreth datës 25 Maj. Paraqitja e një stabiliteti në lidhje me sipërfaqen e kultivuar dhe rritjes së prodhimitarisë së kultivimit të shalqirit në mënyrë të vazhdueshme vitet e fundit duke arritur kulmin e prodhimit në vitin 2019 me 259,698 ton. Ndërkohë që vërehet një ulje e sipërfaqes së mbjellë në 2 vitet e fundit (2018 dhe 2019) por që reflektohet një rritje e sasisë së prodhimit, pra rendimentin, si pasojë e përmirësimit të teknologjisë (259,698 tonë në 2019), një rritje prej 30.2% krahasuar me vitin 2010.

| Shalqi              | 2000    | 2005    | 2010    | 2014    | 2015    | 2016    | 2017    | 2018    | 2019    |
|---------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|
| Prodhimi (ton)      | 250,000 | 204,000 | 199,364 | 216,270 | 235,630 | 240,993 | 252,017 | 239,533 | 259,698 |
| Sipërfaqja (ha)     | 8,300   | 7,000   | 5,488   | 5,748   | 5,950   | 5,376   | 6,129   | 5,681   | 5,549   |
| Rendimenti (ton/ha) | 30      | 29      | 36      | 38      | 40      | 45      | 41.1    | 42.2    | 46.8    |

Bostanorët kryesisht kultivohen në qarqet e Fierit, Tiranës, Durrësit, Beratit, Shkodrës, Lezhës. Në total Shqipëria kultivon bostanorë në një sipërfaqe rreth 6966 ha, ku sipërfaqja me pjepër është jo më shumë se 21% e sipërfaqes. Ndërkohë në shkallë qarku, sipërfaqja më e madhe me bostanorë (shalqi dhe pjepër) mbillet në qarkun e Fierit që zë rreth 36.9% në shkallë kombëtare, Tirana me rreth 15.6%, Shkodra me rreth 11.2% etj. Rendimenti më i lartë vërehet në qarkun e Fierit, me një mesatare prej 61.5 ton/ha, ndërkohë që në disa qarqe të tjera si pasojë e teknologjisë së ulët shikohen rendimente jo-konkurrues, si psh Shkodra me rreth 23.7 ton/ha. Teknologjia kryesisht lidhet me shërbimet agroteknike, në përzgjedhjen e kultivimit të hershëm apo në fushë të hapur, përzgjedhja e fidanit cilësor të prodhuar nga fidanishte të specializuara etj.

| PRODHIMI I BOSTANOREVE NE SHQIPERI - 2019 |             |                 |                |                     |
|---|-------------|-----------------|----------------|---------------------|
| Nr  | Qarqe       | Sipërfaqja (ha) | Prodhimi (ton) | Rendimenti (ton/ha) |
| 1   | Berat       | 281.7           | 13,935         | 49.5                |
| 2   | Diber       | 114             | 3,934          | 34.5                |
| 3   | Durres      | 712             | 22,470         | 31.6                |
| 4   | Elbasan     | 436             | 15,242         | 35.0                |
| 5   | Fier        | 2574            | 158,279        | 61.5                |
| 6   | Gjirokaster | 62              | 1,302          | 21.0                |
| 7   | Korce       | 82              | 2,352          | 28.7                |
| 8   | Kukes       | 29              | 599            | 20.7                |
| 9   | Lezhe       | 517             | 15,035         | 29.1                |
| 10  | Shkoder     | 787             | 18,623         | 23.7                |
| 11  | Tirane      | 1090.94         | 33,484         | 30.7                |
| 12  | Vlore       | 280.3           | 10,609         | 37.8                |
| <b>TOTAL</b>                              |             | <b>6965.94</b>  | <b>295,864</b> | <b>33.6</b>         |

Burimi: Ministria e Bujqësisë

Ndërkohë paraqitet një tjetër pasqyrë në kultivimin e shalqirit, ku kultivimi i kësaj kulture zë rreth 79% të sipërfaqes së kultivuar me bostanorë. Peshën kryesore në këtë sektor e mban qarku i Fierit me një sipërfaqe prej 2,250 ha ose rreth 40.5%. Vendin e dytë në sipërfaqe e zë qarku i Tiranës me 813 ha, ose 14.6%.

| PRODHIMI I BOSTANOREVE NE SHQIPERI - 2019 |             |                 |                |                 |                |
|---|-------------|-----------------|----------------|-----------------|----------------|
| Nr  | Qarqe       | Pjeper          |                | Shalqi          |                |
|   |             | Siperfaqja (ha) | Prodhimi (ton) | Siperfaqja (ha) | Prodhimi (ton) |
| 1   | Berat       | 67              | 2,266          | 215             | 11,669         |
| 2   | Diber       | 36              | 734            | 78              | 3,200          |
| 3   | Durres      | 260             | 7,216          | 480             | 16,740         |
| 4   | Elbasan     | 96              | 2,755          | 342             | 12,594         |
| 5   | Fier        | 371             | 13,817         | 2,250           | 147,376        |
| 6   | Gjirokaster | 23              | 397            | 39              | 905            |
| 7   | Korce       | 42              | 966            | 40              | 1,387          |
| 8   | Kukes       | 11              | 218            | 18              | 381            |
| 9   | Lezhe       | 93              | 1,675          | 424             | 13,360         |
| 10  | Shkoder     | 125             | 2,178          | 662             | 16,445         |
| 11  | Tirane      | 279             | 5,884          | 813             | 27,639         |
| 12  | Vlore       | 92              | 2,607          | 188             | 8,002          |
| <b>TOTAL</b>                              |             | <b>1495</b>     | <b>40,713</b>  | <b>5,549</b>    | <b>259,698</b> |

Burimi: Ministria e Bujqësisë

Vërehet një ulje e sipërfaqes së kultivuar me shalqi si pasojë e ndryshimit të strukturës së mbjellë në disa zona potenciale të Shqipërisë si psh rajoni i Konispolit, një pjesë e rajonit të Beratit. Por ndërkohë vërehet një rritje e lartë e prodhimit dhe rendimentit.

Ajo që vërehet në kultivimin e shalqirit është përmirësim i teknologjisë së aplikuar e cila tregohet qartë në rritjen e rendimentit për njësi të sipërfaqes nga 42.1 ton/ha që ka qënë në vitin 2018 në 46.8 ton/ha në vitin 2019.


Prodhimi i shalqirit në Shqipëri është relativisht më i lartë krahasuar me vendet e tjera Ballkanike por shumë më i ulët se Greqia. Tabela në vijim tregon sipërfaqet e kultivuara me kulturën e shalqirit, prodhimin dhe rendimentin.

| Statistika të prodhimit të shalqirit në Rajon - 2018 |                  |                 |                |                     |
|--|------------------|-----------------|----------------|---------------------|
| Nr.  | Shtetet          | Siperfaqja (ha) | Prodhimi (ton) | Rendimenti (ton/ha) |
| 1  | Greqia           | 9,620           | 630,920        | 65.5                |
| 2  | Shqipëria        | 5,681           | 233,553        | 42.1                |
| 3  | Mali Zi          | 425             | 18,107         | 42.5                |
| 4  | Maqedonia Veriut | 5,281           | 132,091        | 25                  |
| 5  | Bosnia           | 976             | 22,987         | 23.5                |
| 6  | Kroacia          | 1,201           | 32,324         | 26.9                |
| 7  | Serbia           | 6,814           | 199,419        | 29.3                |


Burimi: FAOSTAT

Ajo që vërehet është që pavarësisht se rendimentet tona janë relativisht më të larta se vendet Ballkanike, ato mbeten shumë më të ulta se Greqia, pra kërkohet një ndërhyrje në planifikimin në fermë dhe teknologjinë e aplikuar.

Prodhimi ne vendet e rajonit (ton)



Ky rendiment që paraqet prodhimi i shalqirit në Greqi vjen si pasojë e avantazhit më të lartë se Shqipëria (10-14 dite) dhe shumë më të lartë se vendet e tjera Ballkanike (20-30 ditë) në daljen e produktit në treg. Më poshtë po paraqesim një kalendar të daljes së prodhimit në treg nga vendet e rajonit, ku dhe konkurrenca është e lartë.



Avantazhi konkurrues i daljes në treg si produkt i hershëm rezulton me një performancë financiare të lartë, pra me një gjenerim të ardhurash të larta si rezultat i cmimit të lartë të shitjes. Greqia (kryesisht rajoni i Kretës) është një nga aktorët kryesorë në eksportin e shalqirit në tregun European duke dalë në treg në mesin e muajit Maj, ku cmimi i përfituar arrin vlerën e 1.5 euro/kg. Shqipëria në varësi të kushteve atmosferike, dhe teknologjisë së aplikuar arrin të dalë në treg në javën e katërt të muajit Maj ku shpesh herë arrin të sigurojë cmime në tregje eksporti që variojnë nga 1-1.2 euro/kg. Ndërkohe që në javën e katërt të muajit Qershor penetron në tregjet rajonale por jo vetëm edhe prodhimi i fushës së Maqedonisë së Veriut, Serbisë etj..

### Varietetet e shalqirit të kultivuar në Shqipëri


Shumica e shalqinjve të prodhuar në Shqipëri janë të varieteteve të ndryshme si Crimson Sweet përfshirë Crisby, Florida, Galaxy, Valentina, Paradise, Obla, Top Gun, Star, etj. Përzgjedhja e larmisë kryesisht është e drejtuar nga faktorë të tillë si produktiviteti, rezistenca ndaj sëmundjeve, rezistenca ndaj dëmtimit në transport dhe kosto (farat hibride janë më të shtrenjta). Penetrimi në

tregje rajonale edhe me gjerë ka ndikuar në kultivimin e varietetve të ndryshme të shalqirit bazuar në karakteristika të ndryshme. Shumica e aktorëve të zinxhirit të vlerave mendojnë se madhësia është karakteristika kryesore që duhet të synohet për tregje të ndryshme.

Crimsan Swit (KS - 74). Është varietet me rritje të fuqishme dhe me vegjetacion të bujshëm. Kërçelli kryesor rritet në 3 - 5 m, ndërsa llastaret e degëzimeve të para dhe të dyta shkojnë në 3 - 4 m. Raporti i luleve mashkullore ndaj luleve femërore shkon respektivisht 16 - 18 : 1. Një bimë nxjerr 30 - 35 lule femërore. Fruti është i rrumbullakët me raport H/D = 1.0 - 1.15, me peshë 6 - 8 kg dhe ndonjëherë deri në 25 - 30 kg. 1000 fara peshojnë 45 - 50 gr. Tuli është i kuq me 12 - 14 % lëndë e thatë . Periudha bimore është 95 - 114 ditë. Jep një rendiment 500 - 800 kv /ha.

Sugar Bebi ose (SB - 73). Bima e këtij varieteti ka degëzim dhe shtrirje mesatare të kërçellit në 1.8 - 2.5 m. Trashësia e kërçellit kryesore arrin në 0.6 - 0.8 cm. Gjethet janë të gjelbërta intensive, me lobe, me përmasa mesatare 13 x 11 cm. Ndërnyjet janë të shkurtëra 6 - 9 cm. Lulet mashkullore janë të grupuara në 5 - 6 copë në një sqetull në formë buqete. Lulet femërore janë të veçuara dhe dalin në sqetullat e gjethëve. Lulet e para femërore i nxjerr afër bazës së kërçellit në sqetullën e 6 dhe të 8 të gjethes. Ngjyra e frutit nga lidhja e deri në pjekje është e gjelbërt e errët. Peshë mesatare frutave në një agroteknikë të mirë arrin në 2.5 - 4 kg. Forma e frutit është sferike me raport H/D (gjatësi dhe diametër) = 1.0 - 1.05. Frutat nuk çahen lehtë dhe i durojnë mirë transportit. Ngjyra e tulit është e kuqe e ndezur dhe me shije të ëmbël. Ka mbi 10 % lëndë të thatë . Farat janë të vogla dhe me ngjyrë kafe të hapur të shoqëruara me breza të zbardhur. Peshë e 1000 farërave është 40 - 45 gr. Është varietet i qëndrueshëm ndaj antraknozës dhe fuzariozës. Periudha bimore nga mbirja e deri në pjekje, është rreth 75 ditë.

**Figura.** Fruta nga disa kultivarë shalqiri



### Kultivimi i shalqirit

Sistemi rrënjor është i zhvilluar shumë mirë dhe pjesa më e madhe e saj është e shtrirë në gjatësi 40-50 cm, rrënja kryesore e saj arrin thellësi deri mbi 2 m.

Kërçelli është i zvarritur dhe arrin 3-4 m gjatësi, është 5 brinjësh dhe i mbuluar tërësisht me qimëza. Ai formon një rrjetë të gjerë degëzimesh. Në kushte të përshtatshme lagështie dhe temperature çdo pjesë e kërçellit formon rrënjë adventive. Kjo e fuqizon sistemin rrënjor.

Gjethet janë të vendosura në kërçell me bishta të gjatë deri 10 cm dhe nuk kanë gjethëza. Në sqetullat e gjethëve formohen loze të cilat paraqesin kërcej të transformuar. Gjethja është e ndarë



në pesë pjesë. Madhësia dhe forma e saj është karakteristike e kultivarit.

Lulet e shalqirit janë monoike me lule një seksuale dhe zakonisht në të njëjtën bimë formohen lule mashkullore dhe femërore. Një numër i madh i kultivarëve formon lule mashkullore dhe hermafrodit gjegjësisht dy sektorë. Grupi i tretë i kultivarëve formojnë lule mashkullore, femërore dhe hermafrodit. Në një bimë formohen 15 deri në 60 lule femërore ose hermafroditë dhe 400 deri në 600 lule mashkullore. Së pari lulëzojnë lulet mashkullore të cilat formohen në degëzimet e kërcellit kryesor. Lulëzimi i shalqirit fillon 40 deri në 50 ditë pas mbirjes së farës.

### **Kërkesat ndaj faktorëve të jashtëm**

Shukur çdo kulturë tjetër perimore edhe shalqiri ka kërkesa për faktorët e mjedisit të jashtëm. Shalqiri posaçërisht ndikon ndaj temperaturave të ulëta dhe kur nuk ka dritë të mjaftueshme.

Shalqini ka nevojë për temperatura në të gjitha fazat e rritjes. Farat fillojnë të mbijnë në temperaturë 14 deri në 16°C ndërsa temperatura optimale për mbirje të farave është 30°C.

Nëse dominojnë temperaturat optimale prej 20°C për 5 deri në 6 ditë dalin bimët e para. Nëse temperaturat variojnë, bimët vonohen për mbirje 10 deri në 12 ditë. Temperatura me e përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e shalqinit është 28°C deri në 30°C.

Sa i përket dritës shalqiri ka kërkesa për dritë dhe është bimë e cila kërkon dritë 12 orë në dite apo edhe me shumë. Kërkesat më të mëdha për dritë i ka në kohën kur është duke u rritur, por edhe në kohën e pjekjes së frutave. Nëse gjatë ditës intensiteti i dritës është me i shkurtër vërehen paraqitje të luleve femërore. Nëse drita shkurtohet në 8 orë gjatë ditës atëherë vërehet vonim i rritjes dhe zhvillim i bimës.

Toka. Sa i përket tokës shalqiri kërkon toka të pasura, të shkrifta dhe me materie ushqyese. Më së miri zhvillohet në toka aluviale të cilat janë të thella dhe raportin në mes të rërës dhe argjilës e kanë mirë të rregulluar. Në toka të lehta ranore jep rendimente të ulëta. Po ashtu edhe tokat e rënda të cilat nuk e lëshojnë ujën janë të pa përshtatshme për kultivimin e shalqirit. Tokat më të mira për kultivimin e shalqinjve janë tokat me vlerë të pH neutrale ose tokat me nivel të dobët acidik.

Parakulturë e mirë për shalqirin janë kulturat lavërtare që e lënë tokën të shkriftë. Parakultura më e mirë për shalqirin janë jonxhishtet pasi ato e pasurojnë tokën me materie ushqyese dhe humusore. Ajo zhvillohet mirë edhe nëse mbillet pas qepës, karotës etj.

Shalqiri është parakulturë e mirë për të gjitha bimët me përjashtim të bimëve të familjes bostanore. Sa i përket plehërimit shalqiri shumë mirë reagon në plehërim e sidomos në plehërimin organik dhe atë mineral. Plehu i stallës hidhet para lëvrimit themelor ndërsa meë vonë prapë duhet hedhur plehu organik në gropa për mbjellje të fidanit. Në toka të pasura mjafton të hidhen 30 t/ha pleh i djegur mirë organik, ndërsa 2 deri në 3 kg në çdo gropë.

Sa i përket plehut mineral duhet të hidhen 50 deri në 60 kg N, 80-100 kg P<sub>2</sub>O<sub>5</sub> dhe 80-100 kg K<sub>2</sub>O për ha. Gjysma e sasisë duhet të hidhet para përgatitjes së tokës ndërsa gjysma tjetër hidhet për riplehrim.

Dendësia e mbjelljes së bimëve është relativisht e vogël 3000 deri në 4000 bimë/ha, në varësi nga fuqia vegjetative e nënshartesës dhe e vetë kultivarit të përzgjedhur. Fidani vendoset në mënyrë të atillë që menjëherë pas mbjelljes të duhet të bëhet ujitja për të siguruar 2-3 litra ujë për çdo bimë të mbjellë.



Kryesisht rendet mbulohen me polietilen transparent mbi harqet e vendosura dhe fiksohet mirë duke e mbuluar me dhé të freskët në të gjitha anët e tij. Përgjatë gjatësisë së tunelit, në anën më të mbrojtur nga erërat, hapen disa dritare të vogla, për të kontrolluar zhvillimin e bimëve dhe përmirësuar ajrimin e tyre.

Gjatë kohës së qëndrimit të bimëve në tunel tregohet kujdes i veçantë për parandalimin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme kërpudhore në gjethë. Për këtë qëllim, sa herë që e lejojnë kushtet e motit, bëhet ajrimi i tuneleve, nëpërmjet hapjes për disa kohë të fundeve të tyre. Ndërkaq, fidanët e shartuar garantojnë mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet kërpudhore.

| Periudha bimore                | Temperatura °C | Lagështia ajrore në % | Lagështia e tokës në % |
|--------------------------------|----------------|-----------------------|------------------------|
| Mbirja                         | 24 - 28        | 60 - 70               | 80 - 85                |
| Gjatë periudhës bimore         | 25 - 30        | 60 - 70               | 70 - 80                |
| Gjatë lulëzimit deri në pjekje | 28 - 35        | 60 - 70               | 70 - 80                |

### Mënyrat e Kultivimit

Shalqiri kultivohet në 3 mënyra: i) Në kushtet e fushës së hapur; ii) Në kushtet e tuneleve të ulëta plastike dhe; iii) Në serra.

Në zonat kryesore të kultivimit të shalqirit, fermerët po investojnë në teknologji moderne të prodhimit për të rritur produktivitetin. Teknologji të tilla përfshijnë përdorimin e tuneleve të ulëta, ujitjen me pika, sistemin e fertigimit, përdorimin e varietetëve hibride, dhe mbjelljen me fidanë dhe jo me farëra,



Struktura varietore e rekomanduar. Kultivarët dhe hibridet më të përshtatshëm deri tani janë: Crisby F1; Crimsan Tide F1; Top Gun F1; Crimson star F1; Obla F1; Madera F1; Sumit F1; Paradise F1; Crimsan Swet, e shumë të tjerë.

Në këtë studim kemi marrë në shqyrtim kultivimin e shalqinit në tunele plastike dhe serra.


## Eksportet e shalqirit

Eksportet e shalqinjve kryesisht janë të drejtuara në Kosovë, e cila zë rreth 55-60% të eksporteve të përgjithshme të shalqirit. Destinacione të tjera të rëndësishme për eksport janë Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja Hercegovina përafërsisht, 10% të eksporteve secila. Vende të tjera ku është eksportuar shalqiri shqiptar në vitin 2019 janë: Maqedonia, Kroacia, Çekia, së bashku këto vende zënë rreth 10% të eksporteve të përgjithshme të shalqirit. Shalqinj me madhësi të vogël pa fara janë të preferuara shumë në tregjet perëndimore. Ky duhet të jetë një orientim i qartë që prodhuesit të zhvendosen gradualisht drejt këtij lloji të produktit në mënyrë që të përshtaten me kërkesat dhe preferencat e konsumatorit.

| EKSPORTET E SHALQIRIT PER VITET 2019-2020 |            |              |            |              |
|---|------------|--------------|------------|--------------|
| Muaji                                     | 2019       |              | 2020       |              |
|   | Sasia (kg) | Vlera (leke) | Sasia (kg) | Vlera (leke) |
| Qershor                                   | 11,924,471 | 392,709,942  | 12,610,608 | 326,351,208  |
| Korrik                                    | 15,178,378 | 320,293,688  |            |              |
| Gusht                                     | 2,957,155  | 34,997,160   |            |              |
| Shtator                                   | 2,260,393  | 38,476,991   |            |              |

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nga tabela më lart shikojmë një rritje me 5,7% të sasisë së eksportuar në muajin Qershor 2020 krahasuar me muajin Qershor 2019. Nderkohë që si pasojë e uljes së cmimit të shitjes së shalqirit kemi një rënie të vlerës financiare të akumuluar me 16,9%.



Mundësitë e eksportit për kultivuesit shqiptarë të shalqirit janë të drejtuara në dy tregje të veçantë: tregun rajonal Ballkanik dhe tregjet përtej përfshirjes së BE-së. Shqipëria ka një avantazh gjeografik në të dy tregjet pasi pjesa më e madhe e tregtisë së shalqirit në botë ka tendencë të përqendrohet në rajone të afërta gjeografike, për shkak të kostove të larta të transportit.

Një mundësi premtuese e tregut në të dy tregjet vendase dhe ato të eksportit është shalqiri

i sezonit të hershëm. Kërkesa për shalqi është e lidhur tradicionalisht me rritjen e temperaturës, kështu që kërkesa për shalqi rritet. Ekziston një kërkesë e madhe si në tregjet vendase ashtu edhe në ato eksportuese për shalqirin e sezonit të hershëm. Për shembull, asnjë prodhues në Evropë ose vendet e Komunitetit Europian nuk prodhon aktualisht shalqi përpara mesit të muajit Maj. Megjithatë, kërkesa e tregut fillon të rritet në Pprill, dhe fillon të arrijë kulmin në mes të muajit Maj. Nëse prodhuesit shqiptarë do të ishin në gjendje të avancojnë në hershmërinë e prodhimit do të përballeshin me një konkurrencë të kufizuar, kryesisht të ardhur nga Maroku dhe Amerika Qëndrore, dhe do të mund të komandonin një çmim të lartë për produktin e tyre.

### 3. NDIKIMI I COVID-19 FERMERËT QË KULTIVOJNË SHALQIRIN DHE AKSESI NË TREGJE.

Ndërsa sfidat me të cilat përballen fermerët e zonave rurale ndryshon ndjeshëm sipas kontekstit dhe fazave të pandemisë (para dhe pas pandemisë), ku numri i risqeve është i lartë, duke përfshirë shërbimet gjatë mbjelljes si pasojë e aksesit të zvogëluar tek inputet, për shkak të aksesit të kufizuar në treg dhe uljes së të ardhurave, probleme në vjelje nga mungesa e punës sezonale; transporti në tregjet i zvogëluar për shkak të kufizimeve të lëvizjes; dhe vetë tregjet që kufizohen nga bllokime, distanca fizike dhe së fundmi shumë e rëndësishme rënia e fuqisë blerëse.

**SHALQIRI.** Shqipëria është ndër vendet që ka konsumin më të lartë për frymë të shalqirit në botë (rreth 70 kg/frymë). Shumica e prodhimit të shalqirit (më shumë se 80%) është i destinuar për tregun vendor, dhe kalon nëpër tregje me shumicë dhe më pas drejtpërdrejt te konsumatorët, tregtarët e vegjël dhe dyqanet e shitjes me pakicë. Ndërkohë që tregu vendas ka një konstante të qëndrueshme, rritja e mëtejshme e vëllimit të shitjeve të shalqirit do të duhet të vijë nga prodhimi i varieteteve të sezonit të hershëm, zgjerimi i eksporteve dhe rritja e kërkesave të reja dhe tregje për eksport, si shalqinj me madhësi të vogël dhe pa fara.

| Tregtia | Balanca Tregtare e Eksporteve të Bostanoreve - 2018 |             |
|---------|---|-------------|
|         | Sasia (ton)   | Vlera (USD) |
| Import  | 35,65   | 47,737      |
| Eksport | 19,221  | 3,959,215   |

Pra, sic shikohet në tabelën më lart eksportet e bostanorëve arrijnë vlerën e 3.96 milion dollarë, ndërkohë që importi është i papërfillshëm, vetëm 47,737 dollarë. Por ajo që vërehet është sasia e ulët e bostanorëve të eksportuar nisur nga prodhimtaria në shkallë kombëtare. Eksporti zë vetëm 12% të volumit të prodhuar nga fermerët. Pavarësisht se kemi të bëjmë me një performancë pozitive të sektorit, dhe një balancë tregtare të shkëlqyer, përsëri vlen të theksohet që në krahasim me konkurrentët në rajon, si dhe krahasuar me avantazhet konkurruese që ka Shqipëria, sektori ka nevojë për përmirësime në aksesin e tregjeve. Maqedonia e Veriut e cila për vete kushtet atmosferike dhe pozicionin gjeografik del në prodhim 5 javë pas Shqipërisë, arrin vlerë të akumuluar eksporti për rreth 2.2 milion dollarë. Ndërkohë Greqia me një avantazh pak më të favorshëm së Shqipëria arrin të eksportojë një volum prej 187,248 ton bostanore dhe me një vlerë financiare rreth 63 milion dollarë.

Nisur nga të dhënat e grumbulluara nga Ministria e Bujqësisë dhe intervistat me aktorët e zinxhirit bujqësor, vlerësohet se rreth 55% e shalqirit të kultivuar i përket atij të hershmit.

**TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER KULTUREN E SHALQIRIT QERSHOR 2020**

| Nr                   | Produkti               | Siperfaqja/ha | Prodhim total/Ton | Shpenzime Prodhimi   | Te ardhura te pritshme nga shitja (nivel ferme) | Te ardhura te pritshme nga shitja (nivel grumbulluesi) |
|----------------------|------------------------|---------------|-------------------|----------------------|---|--|
| 1                    | Shalqi i hershem (55%) | 3051.95       | 183,117           | 2,803,979,063        | 5,035,717,500                                   | 5,798,705,000  |
| <b>TOTALI (ALL)</b>  |                        |               |                   | <b>2,803,979,063</b> | <b>5,035,717,500</b>                            | <b>5,798,705,000</b>                                   |
| <b>TOTALI (EURO)</b> |                        |               |                   | <b>22,796,578</b>    | <b>40,940,793</b>                               | <b>47,143,943</b>                                      |

**Shenim** Te dhenat mbi siperfaqet e mbjellura jane siguruar nga te dhenat e Min. Bujqesise per vitin 2019. Rendimentin e shalqirit te hershem ne tunele e kemi perlogaritur me nje rendiment 60 ton/ha, i cili ka tjetër trajtim agroteknik nga shalqiri I fushes. Analizat financiare ne lidhe me rendimentet, shpenzimet dhe te ardhurat e pritshme ne nivel ferme dhe magazine grumbulluese jane hartuar nga autori bazuar ne Kontot.

Pra, fermerët kultivojnë rreth 3052 ha sipërfaqe me shalqi të hershëm, i cili për vete intesitetin e lartë agroteknik rezulton me një rendiment të lartë. Autori ka kalkuluar një mesatare të rendimentit prej 60 ton/ha, që siguron një prodhim afërsisht në 183,117 ton shalqi. Nga kjo sasi e prodhuar, duke iu referuar statistikave të doganave, vetëm rreth 7% e këtij prodhimi kanalizohet në tregun e eksportit, ndërkohë që pjesa tjetër është konsum i brendshëm kombëtar.

Duke analizuar të dhënat e vrojtimit dhe krahasuar me performancën e një viti më parë, situata post pandemike Covid-19 ka pasur këto indikacione në prodhimin e shalqirit të hershëm:

- Prodhimi shalqirit shfaq probleme në dalje në treg si pasojë e kushteve atmosferike, ndërprerje të herëpashërshme të zinxhirit të shërbimeve agroteknike, kushteve atmosferike. Kjo rezultoi që prodhimi të fillonte vjeljen në ditët e para të qershorit, duke humbur aksesin 10 ditor të daljes në treg, ku dhe cmimi është relativisht më i lartë. Kjo ndikoi në hyrjen në tregun vendas të shalqirit nga Greqia, i cili u tregtua në një vlerë rreth 200 lek/kg. Fermerët Shqiptarë humbën një të ardhur të konsiderueshme (pavaresisht volumit të ulët në këtë fashë) financiare, e ardhur kjo që kompenson fashat e tjera të tregtimit ku cmimi mund të ketë luhatje në ulje.
- Respektimi i kalendarit agro-teknik i prodhimit të shalqirit mbetet një pikë kyce në konkurrueshmërinë e prodhimit tonë të hershëm në rajon.
- Certifikimi me standartin GlobalGap krijoi në shume raste probleme me respektimin e kërkesave të tregut të eksportit dhe kryesisht në disa vende perëndimore. Me gjithë masat e marra, disa kompani eksportuese nuk arritën të certifikoheshin në një periudhe kohë të limituar. Aksesin në analizat e MRL (nivelit të mbetjeve në produkt) në laboratorët ndërkombëtarë ndikoi në këto vonesa si pasojë e mos aksesit të shpejtë të dërgesave të mostrave laboratorike (vetëm kompania DHL ofronte shërbim postar të specializuar).
- Gjatë muajit Qershor 2020, kërkesa për kulturën e shalqirit ka pasur jo-stabilitet, pavarësisht se volumi është në rritje në krahasim me vitin 2019, cmimi i indikuar nga tregu i eksportit ka rezultuar shumë i ulët. Mund të shprehemi që cmimi i aksesuar në eksport, është më i ulët në 10 vitet e fundit.
- Paraqitet një tërheqje e ulët e tregut vendas, e cila lidhet me mos-funksionimin e njësive të shërbimit (restorante) dhe hotelerive, pra turizmit në tërësi, por edhe uljes së fuqisë

blerëse të konsumatorit vendas. Theksojmë që pavarësisht hapjes së veprimtarive që lidhen me shërbimin dhe hotelerinë në mesin e muajit Maj, situata e aksesimit nga konsumatorët rezulton shumë e ulët.

- Dalja në treg me një vonesë 10 ditore i dha një mundësi të lartë produktit të Kretës për të vazhduar aksesin në tregjet rajonale dhe ato Europiane.
- Ndërkohë që rreth 25-30% e prodhimit të shalqirit të hershëm ishte akoma në fushë si pasojë e vonesave të prodhimit, krijoi një përballje me prodhimin e fushës së Maqedonisë së Veriut, i cili konkurron në treg me një cmim më të ulët, duke u bërë kështu indikativ në uljet e cmimeve tona të eksportit.

Pavarësisht tregut rajonal, apo cmimeve të aplikuara, fermerët duhet ti kushtojnë vëmendjen e duhur respektimit të afateve të mbjelljes, përzgjedhjes së varietetit dhe fidanit, dhe shërbimeve agroteknike të larta.

Më poshtë pasqyrohen kalendari agro-teknik i kultivimit të shalqirit të hershëm.

| Llojet kryesore të shpenzimeve    | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|-----------------------------------|-------|--------|------|-------|-----|---------|
| Plugimi dhe diskimi i tokës       |       |        |      |       |     |         |
| Mbjellja e fidanëve dhe mulcerimi |       |        |      |       |     |         |
| Shërbimet agroteknike             |       |        |      |       |     |         |
| Ujitja                            |       |        |      |       |     |         |
| Vjelja                            |       |        |      |       |     |         |

Referuar Kartës Teknologjike të prodhimit të shalqirit, e përgatitur nga ekspertët e AASF, rezulton që në 1ha sipërfaqe me tunele e kultivuar me shalqi përfitohet një fitim neto rreth 731,250 lekë. Ky është përfitimi i pritshëm mesatar për fermerët që kultivojnë shalqirin e hershëm në tunele plastike.

| PERFITUESHMERIA E KULTIVIMIT TE SHALQIRIT TE HERSHEM ME TUNELE (HA) |           |                                       |        |
|---|-----------|---------------------------------------|--------|
| Totali i shpenzimeve (leke)   | 918,750   | Kosto e prodhimit (lek/kg)            | 13.1   |
| Te ardhura totale (leke)  | 1,650,000 | Cmimi mesatar i shitjes (leke/kg)     | 23.6   |
| Fitimi neto (leke/ha)   | 731,250   | Marzhi fitimit                        | 44.30% |
| Rendimenti ne piken kritike (kg/ha)                                 | 38,977    | Produktiviteti i punes (kg/dite pune) | 317    |

Ndërkohë një tjetër performancë vërehet në shalqirin e vonshëm të fushës ku intesiteti agroteknik është i ulët dhe si pasojë arrihet një fitim mesatar prej 425,250 lek/ha.

| PERFITUESHMERIA E KULTIVIMIT TE SHALQIRIT NE FUSHE (HA) |           |                                       |        |
|---|-----------|---------------------------------------|--------|
| Totali i shpenzimeve (leke)                             | 574,000   | Kosto e prodhimit (lek/kg)            | 10.5   |
| Te ardhura totale (leke)                                | 1,000,000 | Cmimi mesatar i shitjes (leke/kg)     | 18.2   |
| Fitimi neto (leke/ha)                                   | 425,250   | Marzhi fitimit                        | 42.50% |
| Rendimenti ne piken kritike (kg/ha)                     | 31,611    | Produktiviteti i punes (kg/dite pune) | 303.87 |

Gjatë periudhës 25 Maj – 10 Korrik 2020 është vërtetuar zhvillimi i tregut të shalqirit të hershëm, duke siguruar informacion nga prodhues potencial dhe grumbulluesit/ eksportuesit kryesor. Ky informacion është ndarë në fasha 9 ditore nisur nga fakti që cmimet e tregjeve lëvizin në varësi të prodhimit dhe kërkesës për produkt.

## TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER KULTUREN E SHALQIRIT QERSHOR 2019

| Nr | Produkti | Siperfaqja/<br>ha | Prodhim total/<br>Ton | Shpenzime<br>Prodhimi/ALL | Te ardhura nga<br>shitja (nivel<br>ferme)/ALL | 25 - 31 Maj    | 1 - 5 Qershor    | 6 - 10 Qershor | 11 - 15 Qershor | 16 - 20 Qershor   | 21 - 25 Qershor | 26 - 30 Qershor | 1 - 5 Korrik | 6 - 10 Korrik |
|----|----------|-------------------|-----------------------|---------------------------|---|----------------|------------------|----------------|-----------------|-------------------|-----------------|-----------------|--------------|---------------|
|    |          |                   |                       |                           |   | 2% 100 lek./kg | 5% 70 lek/<br>kg | 10% 45 lek/kg  | 25% 28 lek/kg   | 40% 25 lek/<br>kg | 12% 20 lek/kg   | 6% 20 lek/kg    | 0% lek/kg    | 0% lek/kg     |
| 1  | Shalqi   | 3051.95           | 183.117               | 2.803.979.063             | 5.603.380.200                                 | 366.234.000    | 640.909.500      | 824.026.500    | 1.281.819.000   | 1.831.170.000     | 439.485.800     | 219.740.400     | 0            | 0             |

## TE DHENA STATISTIKORE MBI PRODHIMTARINE DHE TE ARDHURAT PER KULTUREN E SHALQIRIT QERSHOR 2020

| Nr | Produkti | Siperfaqja/ha | Prodhim total/<br>Ton | Shpenzime<br>Prodhimi/ALL | Te ardhura nga<br>shitja (nivel<br>ferme)/ALL | 25 - 31 Maj | 1 - 5 Qershor | 6 - 10 Qershor | 11 - 15 Qershor   | 16 - 20 Qershor | 21 - 25 Qershor | 26 - 30 Qershor | 1 - 5 Korrik | 6 - 10 Korrik |
|----|----------|---------------|-----------------------|---------------------------|---|-------------|---------------|----------------|-------------------|-----------------|-----------------|-----------------|--------------|---------------|
|    |          |               |                       |                           |   | 0% lek/kg   | 4% 65 lek/kg  | 10% 25 lek/kg  | 24% 18 lek/<br>kg | 24% 16 lek/kg   | 16% 14 lek/kg   | 12% 16 lek/kg   | 6% 17 lek/kg | 4% 14 lek/kg  |
| 1  | Shalqi   | 3051.95       | 183.117               | 2.803.979.063             | 3.537.820.440                                 | 0           | 476.104.200   | 457.792.500    | 791.065.440       | 761.766.720     | 410.182.080     | 351.584.640     | 186.779.340  | 102.545.520   |

Pra sic shihet në tabelën e mësipërme në monitorimin e cmimeve në 9 fasha rezulton:

- Volumi i prodhimit të tregtuar në vitin 2020 ka pasur një përthithje më të ulët në shtrirje kohore në krahasim me vitin 2019. Kjo ka ndikuar në performancën e ulët financiare gjatë vitit 2020 si pasojë e mos-përfitimit nga penetrimi i tregjeve në 10 ditëshin e parë të muajit Qershor ku cmimi është relativisht i lartë.
- Fitimi më i lartë (si rezultat i marzhit të lartë) sigurohet gjatë periudhës 25 Maj – 15 Qershor, ku gjatë vitit 2019 është tregtuar 42% e prodhimit, ndërsa në vitin 2020 rezulton një përthithje prej 39% e prodhimit.
- Të ardhurat e gjeneruara në vitin 2020 janë 3,537,820,4400 lekë me një diiferencë negative krahasuar me vitin 2019 ku janë arketuar rreth 5,603,380,200 lekë.
- Gjatë vitit 2020, tregu i shitjes së shalqirit të hershëm ka vazhduar edhe gjatë 10 ditëshit të parë të muajit Korrik, gjë që korrespondon me daljen në treg të shalqirit të Maqedonisë së Veriut, ku cmimi i shitjes është konkurrues në krahasim me prodhimin e hershëm shqiptar. Si pasojë e cmimit të ulët në këto 2 fasha e ardhura e akumuluar nuk rezulton pozitive, dhe plotesisht mund të themi që fermerët në fashen e fundit kanë tregtuar me cmim të barabartë me koston e prodhimit.

### Përmbledhje e rezultatit të vrojtimit

Sic është shpjeguar edhe më lart, nga analiza e fashave të tregtimit të prodhimit të shalqirit të hershëm rezulton një e ardhur e akumuluar shumë herë më e vogël në krahasim me vitin 2019.

Më poshtë po paraqesim një tabelë të përmbledhur për cdo produkt serre të analizuar.

| PRODHIMI I SHALQIRIT |                |                      |                      |                      |
|----------------------|----------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| Nr.                  | Produktet      | Viti 2019            | Viti 2020            | Diferenca ne vlere   |
|                      |                | Vlera e arketuar     | Vlera e arketuar     |                      |
| 1                    | Shalqi hershem | 5,603,380,200        | 3,537,820,440        | 2,065,559,760        |
| <b>TOTALI (ALL)</b>  |                | <b>5,603,380,200</b> | <b>3,537,820,440</b> | <b>2,065,559,760</b> |
| <b>TOTALI (EURO)</b> |                | <b>45,555,936</b>    | <b>28,762,767</b>    | <b>16,793,169</b>    |

Vlen të theksohet që si pasojë e arsyeve të lartepërmendura për gjithë periudhën e monitoruar 20 Maj - 10 Korrik 2020, kemi një humbje të përafert në vlerën e 16.8 mil euro. Megjithatë vlen të përmendet që ky aktivitet i kultivimit të shalqirit të hershëm nuk ka ndikuar në humbje për fermeret, por ka një reduktim të ndjeshëm të fitimit të planifikuar duke rezultuar me një marzh fitimi rreth 12.6% nga 44.3% që ishte planifikuar.

- Vetem në fashën e parë të monitorimit, për arsye të mos-daljes në treg, fermerët kanë humbur një vlerë, rreth 366,234,000 lekë (rreth 4.7 mil euro).
- Edhe në 3 fashat e tjera që i perkasin periudhës 1 Qershor – 15 Qershor, ku cmimi qëndron i konkurrueshëm dhe me fitim të kenaqshëm kemi një diferencë humbje në vlerën e 1,021,792,860 lekë (8.3 mil euro).



## 4. KONKLUZIONE

Gjetjet nga materialet e analizuara dhe anketimet e drejtpërdrejta me aktorë kyc në zhvillimin e bujqësisë ofrojnë një tabllë të qartë ku aktorët kryesorë të zinxhirit vlerës financiare të indikuara nga Covid-19 ndahen në 3 grupe kryesore:

### **Financimi Bankar**

Kërkesa për financimin të sektorit të bostanorëve në Shqipëri është e lartë, dhe kryesisht përfshin institucionet mikro-financiare. Fasha e kreditimit të këtij sektori është mesatarisht 5000 euro/fermer. Kjo situatë e pandodhur më parë në lidhje me kultivimin e shalqirit të hershëm do ketë ndikim në likuidimet e kësteve të kredisë, e cila përgjithësisht është modeluar me menyren "one bullet loan". Ndërkohë situata e kultivimit të shalqirit të vonshëm parashikohet të ketë një skenar më pozitiv në krahasim me kultivimin e shalqirit të hershëm. Zakonisht, fermerët që kultivojnë shalqirin e hershëm, planifikojnë në muajin Korrik-Gusht të kultivojnë një kulturë të dytë, kryesisht kultura e karrotës, lakrës, lulëlakres etj, gjë që mund të kerkojë nga mikro-financa një ri-modelim të kësteve të kredisë për të kompensuar vonesat e likuidimeve të kësteve si pasojë e rënies së cmimit të shalqirit të hershëm. Vlen të theksohet që kjo situatë nuk e bën sektorin e bostanorëve të pa-konkurrueshëm dhe jo-potencial, apo të gjykohet nga sistemi bankar si sektor me një risk të lartë. Ky sektor ka qënë dhe mbetet një potencialitet i madh në politikat bujqësore dhe si i tillë kërkon vëmendje dhe mbështetje financiare, pa anashkaluar vëmendjen e fermerëve ndaj shërbimeve agroteknike. Nga vrojtimit e kryera në këtë studim, vërehet që ndikimi në biznes si pasojë e rënies së cmimit në tregjet europiane ka pasur efekt negativ vetëm në aktivitetin në nivel ferme, ndërkohë që biznesi eksportues (grumbulluesit) rezultojnë me një performancë të lartë financiare.

### **Agrobiznesi.**

- Funksionimi i kontratave me cmime fikse midis prodhuesve dhe eksportuesve tashmë është një domosdoshmëri. Ky bashkëpunim do sjellë edhe një përmirësim të teknologjisë së prodhimit të shalqirit të hershëm, si dhe do të përcaktojë qartë standartet që fermeri duhet të plotësojë, kryesisht ai që lidhet me certifikimin Global Gap.
- Për shumë fermerë që kultivojnë fruta dhe perime, koha midis Marsit dhe Korrikut është periudha e lulëzimit të biznesit bujqësor si pasojë e daljes në treg të prodhimeve të freskëta të serrave, frutave dhe bostanoreve. Por këtë vit, për shkak të shpërthimit të pandemisë fermerët kanë tregtuar produktet e tyre të indikuar nga oferta e paraqitur. Sektori i frutave është goditur më shumë, dhe kryesisht sektori i bostanorëve si pasojë e masave të ndërmarra nga vendet për të luftuar koronavirusin me mungesën e marketingut, blerësve dhe rënia e çmimeve. Mbyllja e dyqaneve, restoranteve, shkollave ka ulur dukshëm hapësirën e tregut për produkte bujqësore me ndikim të madh në sektor, dhe si e tillë fermerët duhet të kërkojnë tregje të tjera qysh në fazën e planifikimit në fermë.
- Fermerët që prodhojnë për shërbime dhe aktivitete të lidhura me fermën, kryesisht restorante dhe turizëm, paraqiten në vështirësi. Pandemia e COVID-19 ka krijuar një rënie

të ndjeshme për sektorin e turizmit në tërësi, në rajon dhe më gjerë. Kjo ka pasoja të rënda ekonomike për sektorin e bujqësisë. Aktivitetet e turizmit rural (bujtinat pritesë, agro-turizmi, turizmi i aventures etj.) paraqiten më të prekurit në këtë sektor, duke qënë se kjo është periudha me frekuentim të lartë nga turistë të huaj, por edhe lokal. Ndërkohë në këtë grupim vecojmë ato subjekte të cilët janë të kredituar nga sistemi bankar, dhe që masat post-pandemike do ta vështirojnë gjenerimin e të ardhurave të planifikuara. Për këtë arsye mund të jetë e nevojshme që fermerët që kultivojnë kulturat 1-vjecare të ndryshojnë strukturën e prodhimit duke e përshtatur me kërkesat aktuale të tregut.

- Një nga arsyet e humbjes së lartë në fitimin e planifikuar për fermerët që kultivojnë shalqirin e hershëm është edhe vonesa e daljes në treg (vonesë minimalisht 10 ditore), prandaj shërbimet agro-teknike me intesitet të lartë dhe respektimi i kalendarit të prodhimit të shalqirit mbetet një pikë kyçe në konkurrueshmërinë e prodhimit tonë të hershëm në rajon.

